



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr 15210 Prot

Shkodër, më 20.10.2023

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të pronës “Agjencia Rrenc“ me nr pasurie 19/2, zk 3168, indeks harte k-34-64-(210-b), me siperfaqe prej 31,165.2 m<sup>2</sup>, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër”

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**VENDIM DELEGIMI**

**Z/KRYETAR**

**Onid BEJLERI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANFERIMIN NË PRONËSI TË PRONËS “AGJENCIA RRENC“ ME NR PASURIE 19/2, ZK 3168, INDEKS HARTE K-34-64-(210-B) , ME SIPERFAQE PREJ 31,165.2 m<sup>2</sup>, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TEK BASHKIA SHKODËR ”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 3 germa k), nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, date 22.02.2001 “Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, date 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per transferimin ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike”, pas shqyrtimit të relacionit nr. \_\_\_\_ .prot, datë \_\_\_\_\_ të administratës së bashkisë Shkodër ;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të bashkisë Shkodër të pronës me të dhëna:
  - “Agjencia Rrenc” (Shtabi i Brigadës së Artilerisë, Ish rep.usht.nr.1190” Rrenc, Shkodër nr.426) me nr. pasurie 19/2, ZK 3168, Indeks i Hartës K-34-64-(210-B), me siperfaqe prej 31,165.2 m<sup>2</sup>, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, referuar dokumentacionit tekniko-ligjor bashkëlidhur.
2. Fusha e përdorimit të kësaj pasurie do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë dhe fushës së përdorimit të pasurisë së sipërcituar, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Mbrojtjes.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**KRYETAR**

**Benet BECI**

**VENDIM DELEGIMI**


**Z/KRYETAR**

**Onid BEJLERI**




Zv/Kryetar

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe  
Trajtimit të AMTP-ve



Drejtoria Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE TRAJTIMIT AMTP

Nr \_\_\_\_\_ prot

Shkodër, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

Lënda: Relacion .

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANFERIMIN NË PRONËSI TË PRONËS  
“AGJENCIA RRENC“ ME NR PASURIE 19/2, ZK 3168, INDEKS HARTE K-34-64-  
(210-B) , ME SIPERFAQE PREJ 31,165.2 m<sup>2</sup>, NGA MINISTRIA E MBROJTJES  
TEK BASHKIA SHKODËR ”.**

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak, Shkodër.

***Të nderuar këshilltarë!***

Në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale dhe objektivave të saj, bashkia Shkodër e ka vlerësuar të domosdoshme ndërtimin e një strehëze për qentë endacak me kapacitet më të lartë se strehëza ekzistuese dhe ambiente ndihmëse.

Sa më sipër, paraqitet e nevojshme vijimi i kësaj procedure administrative për kalimin në pronësi të bashkisë Shkodër të pronës me të dhëna si më poshtë :

- “Agjencia Rrenc”(Shtabi i Brigadës së Artilerisë, Ish rep.usht.nr.1190” Rrenc, Shkodër nr.426), me nr pasurie 19/2, ZK 3168, Indeksi I hartës K-34-64-(210-B), me sipërfaqe të përgjithshme 31 165.2 m<sup>2</sup>, e cila është nën përgjegjësinë e administrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, referuar dokumentacionit tekniko-ligjor bashkëlidhur.

Fusha e përdorimit të kësaj pasurie nga bashkia Shkodër do të jetë sipas percaktimeve të nenit 3 germa k ) ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar: prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

Një pjesë e kësaj pasurie do të vihet në funksion të ndërtimit të strehëzes dhe ambiente ndihmëse.

Ky propozim vjen edhe në vijim të bashkëpunimit institucional me Ministrinë e Mbrojtjes, referuar korrespondencës shkresore nëpërmjet shkresave :

- Shkresë e bashkisë Shkodër nr 10742 prot, datë 28.07.2023 me lëndë “Kërkesë për tranferim objekti”
- Shkresë e Ministrisë së Mbrojtjes me nr.5091/1 prot, datë 22.09.2023 me lëndë ”Kthim përgjigje shkresës nr.10742.prot, date 28.07.2023”

Ministria e Mbrojtjes, me shkresën nr 5091/1 prot date 22.09.2023, në mbështetje të ligjit 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,VKM nr.28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve “Kreu II , paraprakisht kërkon Vendimin e Këshillit Bashkiak dhe ligjshmërinë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër për trajtimin në vijim sipas procedurave të parashikuara në VKM nr.28, datë 27.01.2023, me qëllim përfundimin e procedurave mbi transferimin e kësaj pasurie.

Vlerësojmë se ky propozim gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, nenit 3 germa k), nenit 5 , nenit 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike“.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e kërkesës për tranferimin në pronësi të pronës “Agjencia Rrenc” me nr. pasurie 19/2, zk 3168, indeks harte k-34-64-(210-B), me sipërfaqe prej 31,165.2 m<sup>2</sup>, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër”.

*Duke ju falenderuar!*

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**VENDIM DELEGIMI  
Z/KRYETAR**

**Onid BEJLERI**

**Drejtorja e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe AMTP**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE TRAJTIMIT AMTP

Nr. 10147 Prot

Shkodër, më 28.07.2023

Lënda: Kërkesë për transferim objekti.

Z. NIKO PELESHI

MINISTËR

MINISTRIA E MBROJTJES

Rruga e Dibrës, Tiranë

I nderuar z. Ministër!

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë pushtetit lokal, dhe konkretisht bashkisë Shkodër, kërkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën si më poshtë vijon: Bashkia Shkodër, për nevojat e veta, bën kërkesë pranë institucionit tuaj për transferimin nën administrim të bashkisë Shkodër të pasurisë "Agjencia Rrenc", e cila është nën përgjegjësinë e administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Pasuria në fjalë, me vendodhje Zona Kadastrale 3168, Indeksi i Hartës: K-34-64-(210-B), Nr. Pasurie 19/2 dhe me një sipërfaqe të përgjithshme prej 31,165.2 m<sup>2</sup>, në rast të aprovimit të kësaj kërkesë, parashikohet të përdoret për ndërtimin e strehëzës së qenve endacakë.

Ndërtimi i kësaj strehëze për qentë bazohet në Vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër Nr. 13 datë 20.07.2023 "Për një ndryshim në VKB nr. 71 datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" i Ndryshuar.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin mbetemi në pritje të një përgjigje nga ana juaj.

Bashkangjitur po ju dërgojmë vendodhjen e objektit





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 5081/prot.

Tiranë, më 22.9.2023

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 10742 prot., datë 28.7.2023.

**Z. BENET BECI**  
**KRYETAR I BASHKISË SHKODËR**

**Shkodër**

I nderuar Z. Beci,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 10742 prot., datë 28.7.2023, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, me anë të së cilës keni kërkuar transferimin në administrim të bashkisë Shkodër të pasurisë "Agjencia Renc", cila është nën përgjegjësinë e administrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, pasuri me vendndodhje në zonën kadastrale 3168, indeksi i hartës K-34-64-(210 - B) me nr. pasurie 19/2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 31,165.2 m<sup>2</sup>, e cila parashikohet të përdoret nga bashkia Shkodër për ndërtimin e "Strehës së qenve endacakë", sqarojmë se:

Në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar; të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", që bëjnë fjalë për mënyrën dhe kushtet e transferimit dhe ndryshimit të përgjegjësisë së administrimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në vijim të kërkesës për transferim dërguar me shkresën nr. 10742 prot., datë 28.7.2023, të dërgoni vendimin e këshillit bashkiak për miratimin e transferimit në pronësi të bashkisë Shkodër të kësaj prone dhe konfirmimin e këtij akti nga prefekti i këshillit të qarkut Shkodër, shoqëruar mundësisht me kopjen e projektit. Kjo për faktin se bashkia Shkodër, bashkëlidhur kërkesës për transferim, ka dërguar vendimin e këshillit bashkiak Shkodër nr.13, datë 20.7.2023 "Për një ndryshim në VKB nr.71 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër", i ndryshuar.

Dokumentacioni i sipërcituar, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor të përditësimit të pronës që përgatitet nga Ministria e Mbrojtjes, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr.28, datë 27.01.2023, do të dërgohet pranë ASHK-së, për hartimin e projektvendimit për transferimin në pronësi të bashkisë Shkodër të pronës "Agjencia Renc" për ta përdorur si "Strehë për qentë endacakë".

Gjithashtu Ju bëjmë me dije se nga informacioni i dërguar Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DRRMSH Shkodër), e cila ka në administrim këtë pronë, është konstatuar se nga verifikimi i kryer në terren nga punonjësit e DPRMSH Shkodër, më datë 24.8.2023, në pjesën perëndimore të Agjencisë është kryer një investim (rrethim me

...ina b/a dhe tel gabion), investim i cili është kryer nga bashkia Shkodër me qëllim  
...min e strehës për qentë endacakë.

...idhur me këtë problematikë, sqarojmë se projekti apo investimi i kryer nga bashkia  
Shkodër, nuk duhej zbatuar pa marrë më parë miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila  
pronën e ka në përgjegjësi administrimi dhe nuk mund të lejohet vazhdimi i punimeve, kur  
sipërfaqja e kërkuar e pronës është në proces përditësimi, sipas kriterëve të përcaktuara në  
VKM nr.28, datë 27.1.2023. Bashkia Shkodër mund të vijojë punën për zbatimin e projektit  
brenda territorit të pronës "Agjencia Renc" në administrim të DPRMSH-së, vetëm pas  
miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për transferimin e kësaj prone nga Ministria e  
Mbrojtjes te bashkia Shkodër.

Cenimi i pronës nga ana e bashkisë Shkodër, pa përfunduar procedurat ligjore të transferimit  
të pronës me vendim të Këshillit të Ministrave dhe pa daljen e akteve nga Ministria e  
Mbrojtjes për zbatimin e VKM-së, mund të krijojë probleme në procedurat e dorëzimit dhe  
marrjes në dorëzim të pronës nga komisionet përkatëse që ngrihen nga struktura  
administruese e pronës dhe bashkia Shkodër.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

  
Gelardina Prodan





# PLAN RILEVIMI

Prona nr.426 "Shtabi i Brigadës së Artilerisë, Ish rep. usht. nr.1190" Rrenc, Shkodër

MIRATOHET

Drejtori i Manaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të DPRMSH  
Sokol ZAIMI




## IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 3168  
Nr.Pasurise Vol. Fq  
Indeksi i Hartes K-34-64-(2108-B)  
Shkalla 1: 2500  
Adresa e pasurise Shkodër  
Q/F Rrenc, Shkodër  
Pronari:  
Ministria e Mbrojtjes  
Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Matriale të Shtetit

Hartoi  
Topograf Ramiz HAXHIU  
Shkurt 2021

SISTEMI I KOORDINATAVE KRGJSH  
N 4658624.82  
E 462323.78



N 4658382.55  
E 462601.00

Shpjeguese  
Sipërfaqja e përgjithshme = 31 165.2m<sup>2</sup>  
Sipërfaqja nën objekt = 2.353.1m<sup>2</sup>  
— Kufiri i Repartit

Shënim: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të zbatimit të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Matriale të Shtetit nr.118/1, datë 28.01.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJIU, dhe të hedhur mbi ortofoton e vitit 2015 e çertifikuar nga ASIGU në sistemin koordinativ KRGJSH. Përjashtuar objektin me nr.1, objektet e tjera janë rrënoja.